



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve**

Data: 10.05.2023

Nr: 87

Ora: 11:50

**VENDIM**

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS NR. 23, DATË 06.05.2023 TË KOMISIONERIT SHTETËROR TË  
ZGJEDHJEVE**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 10.05.2023, me pjesëmarrjen e:

<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Koli</b>	<b>BELE</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	-	<b>Anëtar</b>

Shqyrtoi çështjen me:

**KËRKUES:** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**OBJEKT:** Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ gjobë në masën 3 000 (tre mijë) lekë ndaj z. Rakip Suli, kryetar në bashkinë Kamëz.



**BAZË LIGJORE:**

Neni 19, pika 1, shkronja “c” dhe neni 21, pika 1, shkronja “dh” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

**Rrethanat e çështjes:**

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka marrë indicie për publikimin e postimeve me përmbajtje elektorale nga kryetari i bashkisë Kamëz, për të cilat pretendohet nga denoncuesi se postimet me përmbajtje partiake në faqen zyrtare të bashkisë përbëjnë përdorim të burimeve publike. Denoncimi me nr. 347 ID është marrë nëpërmjet provave link dhe materialeve fotografike, të administruara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet raportit të KRIIK.
2. Në këtë denoncim pretendohet se në faqen zyrtare “Facebook” të kryetarit njëkohësisht dhe kandidat për kryetar bashkie, z. Rakip Suli janë përdorur slogane elektorale, në formën e hashtag (#) në mbështetje të “Partisë Socialiste të Shqipërisë”.
3. Mbi këtë bazë, Komisioneri ka nisur hetimin administrativ ndaj z. Rakip Suli, kryetar në bashkinë Kamëz. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioneri ka arritur në konkluzionin se z. Rakip Suli ka shkelur pikën 1, të nenit 91 të Kodit Zgjedhor, pasi ka vënë në dispozicion faqet zyrtare “facebook” të institucionit publik që drejton, për të publikuar postime me përmbajtje hashtag, slogane apo thirrje të karakterit elektor/politik, duke promovuar kështu subjektin zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” për zgjedhjet vendorë të datës 14 Maj 2023.
4. Me anë të vendimit nr. 443, datë 05.05.2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka urdhëruar fshirjen e menjëhershme nga faqet zyrtare të rrjetit social “Facebook”, të çdo postimi apo ripostimi në të cilat janë përdorur hashtag me përmbajtje elektorale.

5. Komisioneri ka vënë në lëvizje KAS-in me anë të një kërkesë, duke kërkuar marrjen e masës administrative me gjobë ndaj kryetarit të bashkisë Kamëz z. Rakip Suli, në masën 3 000 (tre mijë) lekë, sikurse parashikohet nga dispozita e nenit 171 pika 1 e Kodit Zgjedhor.
6. KAS-i caktoi me short z. Ilirjan Rusmali relator për shqyrtimin e kërkesës nr. 23, datë 06.05.2023 të Komisionerit dhe në seancën paraprake vendosi pranimin për shqyrtim të kërkesës, duke e caktuar seancën e shqyrtimit më datë 10.05.2023, ora 11:50.
7. Seanca e datës 10.05.2023 u zhvillua me praninë e Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së, si përfaqësues i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe të specialistëve të administratës së KQZ-së. Kryetari i bashkisë Kamëz, i njoftuar rregullisht nuk u paraqit në seancën e shqyrtimit.
8. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:
  - Kërkesën nr. 23, datë 06.05.2023 të Komisionerit;
  - Vendimin nr. 443, datë 05.05.2023 të Komisionerit;
  - Denoncimin nr. 347 ID të KRIIK, bashkëlidhur provat materiale fotografike.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve përfundimtare,

#### **KAS-i konstaton:**

1. Kërkesa e Komisionerit për vendosjen e sanksionit administrativ ndaj z. Rakip Suli, kryetar i bashkisë Kamëz, bazuar në denoncimin me nr. 347 ID të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), ka lidhje me postimet në faqen zyrtare "Facebook" të bashkisë, të aktiviteteve elektorale të kryetarit aktual dhe njëkohësisht kandidatit të Partisë Socialiste në këtë bashki. Denoncimi referon në 5 postime të veprimtarive zgjedhore të kandidatit të Partisë Socialiste. Raporti XIV i KRIIK, ku përfshihen këto denoncime, mban datën 25.03.2023, d.m.th. është paraqitur 20 ditë përpara fillimit të "periudhës së fushatës zgjedhore" dhe bën fjalë për ngjarje që kanë ndodhur përpara kësaj date.

2. Faqet zyrtare të institucioneve publike në rrjetet e ndryshme sociale (*Facebook, Tëitler, Instagram* etj.) bëjnë pjesë në kategorinë “asete”, në kuptim të pikës 2 të nenit 91 të Kodit Zgjedhor, që do të thotë se janë burime të institucionit sipas kësaj dispozite. Kjo do të thotë se faqja zyrtare e *Facebook* e bashkisë “*nuk mund të përdoret ose të vihet në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në ZGJEDHJE*”.
3. KAS-i e ka trajtuar këtë kazus në 5 vendime të vetat të mëparshme, në vendimin nr. 45, datë 04.04.2023, në vendimin nr. 54, datë 11.04.2023, në vendimin nr. 56, datë 11.04.2023, në vendimin nr. 75, datë 02.05.2023 dhe në vendimin nr. 84, datë 08.05.2023. Në të gjitha rastet, KAS-i ka sensibilizuar organet e tjera drejtuese të KQZ-së, Komisionerin dhe Rregullatorin për defektin që bart vendimi i Rregullatorit nr. 9, datë 24.12.2020 lidhur me mungesën e një afati të përcaktuar, pas të cilit u ndalohej institucioneve të vënë në përdorim ose në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve burime institucionale. Analiza ligjore po jepet e përsëritur edhe në vijim.
4. Pika 1 e nenit 91 të Kodit Zgjedhor përcakton se “... *nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve NË ZGJEDHJE burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia*”. Kjo dispozitë është përsëritur në mënyrë të ngjashme edhe nga vendimi i Rregullatorit nr. 9, datë 24.12.2020 në përkufizimin e “*veprimtarive të ndaluara*” kur ndalon “*vënien në dispozicion të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme ... për QËLLIME ZGJEDHORE*”.
5. Kodi Zgjedhor ka përcaktuar periudhën e fushatës zgjedhore, si një periudhë që zgjat nga 30 ditë para datës së zgjedhjeve, deri 24 orë para datës së zgjedhjeve (neni 77), ka përcaktuar periudhën kur nuk lejohet propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve të caktuara ligjore ose nënligjore, e cila është katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve (pika 4 e nenit 91), por nuk ka përcaktuar periudhën kur vepron ndalimi sipas pikës 1 të nenit 91, kur fillojnë “**ZGJEDHJET**” dhe as kur mbarojnë ato. Nga ana tjetër nuk ka asnjë akt me karakter normativ nga ana e KQZ-së që të përcaktojë momentin kur fillon të veprojë ndalimi i përdorimit

të burimeve të organeve apo enteve publike që kërkon ky nen. Vendimi i Rregullatorit nr. 9, datë 24.12.2020 nuk e ka saktësuar këtë përkufizim. Në nënpikën 1.3, të pikës 1 të nenit 3 të tij, teksta jep përkufizimin e “veprimtarive të ndaluara”, vendimi cakton afatin për të cilin vepron ndalimi për secilën nga kategoritë e veprimtarive të ndaluara, me përjashtim të veprimtarive të përkufizuara nga shkronja “c” dhe nga shkronja “dh” e tij, për të cilat nuk ka afat.

6. Në kushtet e mungesës së një përcaktimi detyrues që do t’u vendoste fillimin e veprimit të afatit të ndalimit në një datë më të hershme, subjektet zgjedhore dhe institucionet janë të lira ta çojnë afatin në limitin e tij ligjor, që është data e fillimit të fushatës zgjedhore, d.m.th. 30 ditë përpara datës së zgjedhjeve. Kjo nuk do të formonte shkelje të ligjit, sepse **“PERIUDHA E FUSHATËS ZGJEDHORE”** sikurse është përcaktuar nga Kodi Zgjedhor e mbulon konceptin **“ZGJEDHJE”** të pikës 1 të nenit 91.
7. KAS-i mund të marrë masa administrative ndaj subjekteve ose përfaqësuesve të institucioneve vetëm nëse konstaton shkeljen e dispozitave të caktuara detyruese ligjore, por nuk mund të sanksionojë administrativisht për veprime, të cilat nuk është ligjërisht e qartë nëse janë kryer brenda apo jashtë periudhës së ndalimit. Kuadri ligjor i paqartë nuk mund të zbatohet në dëm të subjekteve. **NDËSHKIM PA SHKELJE DHE PA FAJ NUK MUND TË KETË.**
8. Nëse kuadri rregullator i zgjedhjeve do ishte kompletuar edhe me përkufizimin e afatit kur fillon të veprojë ndalimi sipas pikës 1 të nenit 91, duke e lidhur atë me periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve, atëherë 5 postimet e denoncuara të veprimtarive zgjedhore të kandidatit të Partisë Socialiste në faqen zyrtare të bashkisë Kamëz në rrjetit social *Facebook* do të formonin keqpërdorim të burimeve publike.
9. Pika 1 e nenit 172 të Kodit Zgjedhor përcakton se *“subjektet zgjedhore kryejnë kundërvajtje administrative në rastet kur në favor të tyre kryhen shkelje të ndalimeve të përcaktuara në dispozitat e këtij ligji dhe subjektet zgjedhore, pas marrjes dijeni, nuk marrin masa të menjëhershme për ndërprerjen e shkeljes”*. Kjo do të thotë se **HETIMI ADMINISTRATIV PËR KEQPËRDORIMIN E BURIMEVE PUBLIKE DUHET TË SHOQËROHET NË ÇDO RAST EDHE ME HETIMIN PËR ROLIN E SUBJEKTIT ZGJEDHOR PËRFITUES NGA VEPRIMTARIA**. Në përfundim të

hetimit administrativ si Komisioneri, ashtu dhe KAS-i duhet të mbajnë qëndrim dhe vlerësim të shprehur për këtë rol.

10. Pika 1 e nenit 171 të Kodit Zgjedhor përcakton sanksionin për shkeljet e kryera “nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve ose nga **PERSONA TË NGARKUAR ME DETYRA**, sipas këtij Kodi”. Personat e ngarkuar me detyra formojnë një listë personash/institucionesh të cilët janë ngarkuar me detyra nominalisht nga Kodi Zgjedhor. Të tillë janë p.sh. vëzhguesit a përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore në KQZ (për etikën e punës e të komunikimit), Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (për dërgimin e të dhënave nga regjistri për ndarjen e zonave të administrimit zgjedhor, për listën e zgjedhësve etj.), zyra e gjendjes civile dhe kryetari i bashkisë (për listën e zgjedhësve), kryetari i bashkisë (për caktimi e qendrave të votimit), Ministri që ka në varësi shërbimin e gjendjes civile (për nxjerrjen e urdhrave për listat dhe zonat e qendrave të votimit) etj.. Fakti se ata dhe detyrat e tyre përcaktohen nga Kodi do të thotë se lista e tyre është e fundme dhe nuk mund të shtohet me ndonjë akt tjetër ligjor ose nënligjor. **Titullari i institucionit apo entit që ka në administrim asetin publik nuk bën pjesë në listën e “personave të ngarkuar me detyra, sipas Kodit”.** **SANKSIONI PËR TË NUK MUND TË VENDOSSET SIPAS PIKËS 1 TË NENIT 171 TË KODIT ZGJEDHOR.** Dispozita e aplikueshme për sanksionim mbetet ajo e pikës 2 të nenit 171.
11. Ky arsyetim ligjor i KAS-it mund të konsiderohet tashmë jurisprudencë solide. Ajo mund të ndryshohet vetëm në dy mënyra, në rrugën e shqyrtimit gjyqësor, ose në rrugën e përmirësimit të kuadrit rregullator. Për këtë arsye, **KAS-i FTON ADMINISTRATËN E KQZ-SË TË NDJEKË ME MË SHUMË VËMENDJE DHE RESPEKT VENDIMMARRJET E KAS-it DHE TË KZGJ-së DHE TË PËRQASË PRAKTIKAT E VETA HETIMORE ME KËTO VENDIMMARRJE.**
12. Kjo është analiza për faktet e denoncuara nga KRIIK në raportin XIV të tij.
13. Komisioneri ka urdhëruar me vendimin nr. 443, datë 05.05.2023 “fshirjen e menjëhershme të çdo postimi apo ripostimi me karakter elektoral nga faqja zyrtare e bashkisë Kamëz”. Nga verifikimi nëpërmjet aksesit në faqen zyrtare të bashkisë konstatohet se bashkia Kamëz e ka zbatuar këtë urdhërim brenda ditës. Të gjitha postimet e denoncuara janë aktualisht të paaksesueshme. Por

fshirja e postimeve është bërë 20 ditë pas fillimit të periudhës së fushatës zgjedhore. Për 20 ditë bashkia Kamëz ka qenë në shkelje të ndalimit të përcaktuar nga pika 1 e nenit 91 të Kodit Zgjedhor, sepse në faqen e saj të Facebook ka pasur të afishuara dhe të aksesueshme për publikun postime me karakter të qartë elektorale. **KAS-i e ka detyrë që të veprojë kur gjatë shqyrtimit administrativ vihet përpara fakteve dhe provave që vërtetojnë kryerjen e shkeljeve të tjera nga ato të parashtruara në kërkesë.**

14. Për keqpërdorimin e burimeve publike Kodi Zgjedhor ngarkon me përgjegjësi edhe subjektet zgjedhore përfituese. Kodi Zgjedhor, në pikën 20 të nenit 2 përcakton se *“subjekte zgjedhore” janë partitë politike, koalicionet dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, si dhe **KANDIDATËT PËR KRYETARË TË ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE**, të regjistruar në përputhje me këtë Kod*”. Për shkak se kandidati për kryetar bashkie trajtohet nga Kodi si subjekt zgjedhor i mëvetësishëm, si dhe për shkak se postimet e aksesueshme në Facebook bëjnë fjalë për veprimtari elektorale të tij dhe jo të subjektit që e mbështet (*#MeRakipSulin #VetëmPërpara#VotoNr1*), atëherë për këto shkelje duhet trajtuar subjekt zgjedhor përfitues, kandidati dhe jo partia politike që e mbështet atë.
15. Kandidati për kryetar bashkie në bashkinë Kamëz gëzon status të dyfishtë, si kandidat dhe si Kryetari në detyrë i bashkisë Kamëz. Si kryetari i bashkisë, z. Rakip Suli ka akses, dijeni dhe përgjegjësi për postimet në faqen zyrtare të bashkisë që ai drejton. Ai ka gjithë pushtetin e nevojshëm ligjor për të urdhëruar ndërprerjen e shkeljes së ligjit dhe për të marrë masa që kjo sjellje të mos përsëritet. Fakti që ai nuk e ka ushtruar këtë pushtet deri ditën e urdhërimit nga Komisioneri do të thotë se ai duhet t’i nënshtrohet, si subjekt zgjedhor, veprimit të sanksionit të parashikuar nga pika 1 e nenit 172 të Kodit Zgjedhor. Për procedimin apo caktimin e masës së sanksionit, KAS-i duhet të çmojë dhe t’i japë peshën që i takon faktit se ende nuk ka perceptim të qartë ndër aktorët se përdorimi i adresës zyrtare të institucionit në *“Facebook”* për fushatë elektorale përbën keqpërdorim të burimeve publike.
16. Përgjegjësia për vendosjen në përdorim apo në mbështetje të kandidatëve apo të subjekteve zgjedhore të faqeve zyrtare të institucioneve publike është e kryetarit të bashkisë. Këtë e saktëson vendimi i Rregullatorit nr. 9, datë 24.12.2020, nëpërmjet shkronjave “a” dhe “dh” të

pikës 1 të nenit 7. Gjithsesi, KAS-i konstaton se KQZ-ja nuk ka sensibilizuar në kohë publikisht, sikurse nuk ka paralajmëruar institucionet për largimin nga praktika e vjetër e përdorimit politik të faqeve të institucioneve në rrjetet sociale. Ndëshkimi administrativ nuk është qëllim primar i Kodit Zgjedhor. Përpara tij vjen informimi, edukimi, paralajmërimi. Për shkak se këto mundësi KQZ-ja nuk i ka vënë në shfrytëzim për këtë tipologji shkeljesh, KAS-i heq dorë nga procedimi i kryetarit të bashkisë, sipas pikës 2 të nenit 171 të Kodit Zgjedhor.

17. Bazuar në këtë analizë të fakteve dhe të kuadrit ligjor, KAS-i çmon se kryetari i bashkisë, në cilësinë e tij si kandidat për kryetar bashkie, subjekt zgjedhor përfitues nga keqpërdorimi i adresës zyrtare të institucionit në rrjetin social *Facebook*, duhet të mbahet përgjegjës për shkelje të parashikuar nga pika 1 e nenit 172 të Kodit Zgjedhor.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 21, pika 1, shkronja 'dh', të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, me shumicë votash

#### **V E N D O S I:**

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës nr. 23, datë 06.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për vendosjen e sanksionit administrative për denoncimin nr. 347 ID.
2. Vendosjen e sanksionit administrative ndaj z. Rakip Suli, kandidat për kryetar në bashkinë Kamëz, në masën 100 000 (njëqind mijë) Lekë, bazuar në nenin 172, pika 1, të ligjit 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.



Bazuar në pikën 1 të nenit 145 të Kodit Zgjedhor, kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij, sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 152 të Kodit Zgjedhor.  
U shpall sot më datë 10.05.2023.

<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Koli</b>	<b>BELE</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	-	<b>Anëtar</b>

## MENDIM PARALEL

1. Në shqyrtimin e kërkesës nr. 23, datë 06.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me objekt *“Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ”*, ne, anëtarët Elvis Çefa dhe Ledio Braho, pavarësisht se jemi dakord me anëtarin Ilirjan Rusmali të KAS në lidhje me pranimin e kërkesës së KSHZ, kemi mendim paralel sa i përket periudhës së ndalimit, për të cilën jemi të mendimit që nuk ka asnjë *“ometim ligjor”*.
2. KAS e trajton institutin e ndalimit të përdorimit të burimeve publike si në kushtet e *“ometimit ligjor”*. Ometimi ligjor është koncept tashmë i afirmuar në doktrinën juridike, praktikën gjyqësore dhe, në veçanti, atë kushtetuese. Ometimi është identifikuar, si në rastet kur norma juridike nuk ka rregulluar një marrëdhënie të caktuar, që në të vërtetë duhej të rregullohej (*ometimi absolut*), ashtu edhe kur norma nuk ka arritur të përmbushë në mënyrën e plotë dhe të duhur këtë detyrim (*ometimi relativ*).
3. Për ne anëtarët me mendim paralel, neni 91 pika 1 e K.Zgjedhor, në lidhje me mospërdorimin e burimeve publike nuk është në kushtet e konceptit të *“ometimit relativ”* për shkak të afatit, pasi kjo dispozitë duhet interpretuar së bashku me pikat e tjera të nenit 91 si dhe me nenin 92 të K.Zgjedhor. Më konkretisht, neni 91 pika 1 e K.Zgjedhor përcakton parimin e mospërdorimit të burimeve publike në zgjedhje (pa përcaktuar termin fushatë zgjedhore që detyrimisht të referon te afati 30 ditë nga dita e zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve), më tej pika 2 e nenit 91, në fjalinë e parë jep kuptimin e *“burimit”* duke përkufizuar llojet e burimeve në asete të luajtshme dhe të paluajtshme si dhe në burime njerëzore, ndërkohë në fjalinë e dytë parashikon mospërdorimin e burimeve njerëzore (duke e përcaktuar në mënyrë eksplicite vetëm për burimet njerëzore) në fushatë zgjedhore, në këtë mënyrë vendoset dhe afati i ndalimit të burimeve njerëzore. Në pikën 3 të po të njëjtit nen, trajtohet sërish koncepti i burimeve njerëzore, por tashmë në kuptim të marrjes në punë, pushimit nga puna etj. dhe afati edhe në këtë rast lidhet me periudhën e fushatës zgjedhore. Më tej, në pikën 4 të po të njëjtit nen trajtohet një veprimtari tjetër që ka të bëjë me iniciativat ligjore apo nënligjore dhe këtu afatin e ndalimit ligjvënësi e përcakton në harkun kohor 4 muaj para ditës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë. Neni 92 i K.Zgjedhor, në pikën 1 të tij parashikon se *“1.*

*Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve. Formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre".* Më tej, në pikat 2 deri 6 të këtij neni, detajohet mënyra e raportimit, rastet kur ndalohen aktivitetet nga KQZ etj..

**4. Nga arsyetimi më sipër, del qartë që për aq kohë sa raportimi i aktiviteteve publike duhet të kryhet gjatë gjithë periudhës 4 muaj para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve, atëherë edhe ndalimi i përdorimit të burimeve publike vlen për të njëjtën periudhë. Nëse arsyetojmë *a contrario*, që nëse ndalimi i përdorimit të burimeve publike do të vlente vetëm periudhën zgjedhore, atëherë përse duhet të raportoheshin aktivitetet edhe për periudhën e hershme 4 muaj përpara datës së zgjedhjeve?! Një interpretim i tillë e bën dispozitën alogjike dhe e shndërron në fiktive. Ndaj, për ne anëtarët në pakicë të KAS, neni 91 pika 1 nuk është në kushtet e konceptit të "ometimit relativ" sa i përket afatit të zbatimit të dispozitës, por është një dispozitë me karakter detyrues për periudhën 4 muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.**

5. Për sa më sipër, ne vlerësojmë se kërkesa e KSHZ duhet të pranohej për të gjithë periudhën që fillon nga momenti i ripostimit në datë 25.03.2023 e deri në datën 05.05.2023, ditën që postimet janë fshirë.

**Anëtarë: Elvis Çefa, Ledio Braho**